



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 463-01/46786, datë:30.Qershor 2020.

Në bazë të dispozitave të nenit 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të nenet 24 dhe 25 të Ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronësisë paluajtshme të Komunës Ligji Nr. 06/L-092, si dhe nenit 36 të Statutit të Komunës së Pejës, 01. Nr. 09-8103 dt. 29.09.2008 , pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private të pronarit Din Jusaj nga Peja, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur me dt. 30. Qershor 2020, muarr:

V E N D I M

Nr. 32/2020

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME KOMUNALE ME PRONËN PRIVATE PËR REALIZIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN "ZATRA" NË PEJË

I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e personit fizik , e më qëllim të **sigurimit të hapësirës publike për gjelbërim ne Lagjen Zatra sipas Planit rregullues Urban "Zatra" Pejë.**

II. Për realizimin e këtij këmbimi sipas këtij Vendimi është propozuar që të zhvillohen procedurat e nevojshme ligjore për këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës për interes publik **me qëllim të sigurimit të hapësirës publike për gjelbërim ne Lagjen Zatra sipas Planit Rregullues Urban "Zatra" Pejë, për realizimin e këtij interesi publik pronarit privat Din Jusaj nga Peja** për pronën e tij private e cila gjendet në ngastrën kadastrale 5323/6 në sipërfaqe prej 484 m2 ZK Pejë, i është propozuar këmbimi me ngastrën kadastrale 295/30 në sipërfaqe prej 625 PSH e KK Pejë, ZK Bellopojë, ndërsa vlerësimin ligjor do ta bëjë Zyrja për vlerësimin e paluajtshmërisë në kuadër të Ministrisë për Financa.

III. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Komuna në afat prej pesë ditëve e paraqet kërkesën për vlerësimin e pronave të paluajtshme sipas pikës II të këtij vendimi Zyrës për Vlerësimin e pronës së Paluajtshme pran Departamentit të Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave.

IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:

- 1x1 MAPL-së
- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 DÇPJ
- 1x1 Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT
Dr. Islam Husaj